

URDHËR
Nr. 165, datë 9.6.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 14, DATË 16.1.2020 “PËR SHPALLJEN E
‘THIRRJES SË PESTË’, NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE
TË PUNËS”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore dhe në institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, dhe të pikës 7, të urdhrit nr. 351, datë 29.5.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19”,

URDHËROJ:

1. Në metodologjinë dhe Planin e Veprimit në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, “Thirrja e Pestë”, bashkëlidhur urdhrit nr. 14, datë 16.1.2020, bëhen këto ndryshime:
 - a) në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3, data “9 mars 2020” zëvendësohet me datën “12 qershor 2020”.
 - b) shkronja “b” e pikës 4, ndryshon si më poshtë:
“b) Programi fillon më datë **12 qershor 2020** dhe përfundon më datë **12 shtator 2020**”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini